



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 104, datë 31.05.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË  
VEPRIMTARISË SË BROKERIT NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

Znj. Dhorothea Male është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin e Bordit nr. 11, datë 31.01.2018 “Për ushtrim veprimtarie brokerimi në sigurime, në klasat e jetës, jojetës dhe risigurimeve” dhe mban Licencën nr. 73, datë 31.01.2018.

Me shkresën nr. 1260, datë 02.05.2023, znj. Dhorothea Male parashtron se tërhiqet vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë si “Broker në sigurime”.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe kërkesës së vetë subjektit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e kërkesës së zj. Dhorothea Male për heqjen e Licencës nr. 73, datë 31.01.2018 “Për ushtrim veprimtarie brokerimi në sigurime, për klasat e jetës, të jojetës dhe risigurimeve”.**
- 2. Çregjistrimin nga regjistri i të licencuarve pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR  
Idlir GJATA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**